

FJALA E DEPUTETES DHURATA ÇUPI

E ENJTE 10 SHKURT 2022

Zotërinj deputetë,

Kur Kuvendi votoi në vitin 2016, me 140 vota pro dhe asnjë kundër, paketën kushtetuese, synonte ndryshimin rrënjësor të gjyqësorit, ngritjen e disa institucioneve të reja të drejtësisë dhe ndërtimin e një kulture besimi të qytetarëve shqiptarë te pushteti gjyqësor dhe tek të gjithë aktorët institucionalë që e përbëjnë atë. Të bindur për problemet e këtij sistemi, ne vendosëm të kalonim në Kuvend ndryshimet më të rëndësishme kushtetuese të dy dekadave të fundit. Por çfarë ndodhi? Largimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve nga vetingu ka sjellë një rekord të ri në mbingarkesën e sistemit dhe zvarritjen e çështjeve, ndërsa ekspertët janë të paqartë se sa kohë do t'i duhet Shqipërisë për të krijuar një gjeneratë të re magistratësh për të zëvendësuar të larguarit. E ndërsa pritej ndryshimi, largimi i një numri të paparashikueshëm gjyqtarësh dhe prokurorësh e ka precipituar situatën në një krizë për magistratë të rinj, në një stok të madh dosjesh në pritje, si dhe në zgjatjen e kohës së shqyrtimit të tyre. Për më tepër, aktorët e sistemit të drejtësisë janë të paqartë se kur situata mund të kthehet në normalitet. Sipas ekspertëve, nëse do të ruhet kjo status quo, 10-vjeçari i ardhshëm do të jetë tepër i vështirë për sistemin e drejtësisë. Të dhënat tregojnë rritje të numrit të çështjeve për gjyqtarët dhe prokurorët nga viti 2016 deri në mesin e vitit 2021. Kjo ka sjellë zvarritje të mëtejshme dhe gati trefishimin e kohës mesatare të përfundimit të këtyre çështjeve. Në 5 vjetët e fundit volumi i punës është rritur nga dyqind në dymijë dosje për çdo gjyqtar, ndërsa koha mesatare e zgjidhjes së një çështjeje është rritur mesatarisht nga 180 ditë në 730 ditë. Nga ana tjetër, ka struktura të kompromentuara politikisht, të cilat Partia Demokratike nuk ka nguruar t'i denoncojë me fakte dhe me prova në vazhdimësi.

Pas shkrirjes nga vetingu, Gjykata e Lartë po ringrihet me vështirësi dhe ka sot 9 gjyqtarë nga 19 që duhet të ketë. Ndërsa sistemi shqiptar i drejtësisë po vuan të gjejë gjyqtarë dhe prokurorë të rinj, treguesit mbi volumin e punës dhe kohëzgjatjen e çështjeve ekspozojnë një situatë ngërçi në të gjitha nivelet. Nga viti 2016 e deri më sot në gjykatat e apelit numri mesatar i dosjeve për çdo gjyqtar është rritur nga 335 në 628, ndërsa koha e shqyrtimit të një çështjeje civile është rritur me 3,5 herë; nga 214 ditë në 765 ditë për të njëjtën periudhë. Përpara fillimit të reformës në vitin 2016, çdo gjyqtar i shkallës së parë gjykonte mesatarisht 330 çështje në vit, ndërsa në vitin 2020 ky numër është rritur në 407 çështje. Si rrjedhojë, koha mesatare e shqyrtimit të një çështjeje civile është dyfishuar nga 160 ditë në vitin 2016 në 320 ditë në vitin 2020. Prokurorët që shërbejnë sot në shkallë të parë patën, gjithashtu, një rritje të numrit mesatar të çështjeve nga 166 në 219 në periudhën 2016- 2020. Nuk duhet të harrojmë se vetingu në Gjykatën Kushtetuese e nxori këtë gjykatë jashtë funksionit për 3 vjet me radhë. Mungesa e funksionimit të kësaj gjykate solli si rrjedhojë mosshqyrtimin e çështjeve të rëndësishme për kohën dhe opinionin publik, si ajo e Teatrit Kombëtar, i cili u shemb në mënyrë arbitrare nga qeveria, por që 1 vit më pas, Gjykata Kushtetuese, e rikthyer në funksion pas betimit të anëtarëve të rinj, e shpalli antikushtetues kalimin e pronësisë së Teatrit Kombëtar nga Ministria e Kulturës te Bashkia e Tiranës. Ky boshllëk institucional solli jo vetëm tensionimin e klimës politike në vend, por mbi të gjitha, shkatërrimin e teatrit, një pasuri e rëndësishme e trashëgimisë tonë kombëtare.

Mbingarkesa në sistemin gjyqësor është një ndër problemet më të mprehta që vetingu solli mbi sistemin, por edhe mbi qytetarët shqiptarë, të cilët do të duhet të presin për një kohë të pacaktuar

për zgjidhjen e çështjeve të tyre. Në fakt, kjo është çështja më kryesore. Ky është një çmim që Shqipëria po e paguan dhe shqiptarët po e paguajnë e do të vazhdojnë ta paguajnë deri në stabilizimin e plotë të sistemit dhe garantimin e së drejtës për një drejtësi të paanshme, të pavarur dhe efikase. Më vjen keq ta ripohoj, por nuk ka garë të mirëfilltë për vendet vakante në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe atë të Prokurorisë. Përzgjedhja e fundit, e 4 kandidatëve për 4 vende, që votohet sot në këtë sallë, është bërë fiktive, e njëanshme dhe pa garë të platformave. Kjo është në kundërshtim me frymën e reformës në drejtësi dhe ngritjen e organeve të reja të drejtësisë. Gara duhet të jetë në themel të çdo posti të lartë në sistemin e drejtësisë. Kjo reformë nuk bëhet për t'i gjetur Kolës punë. Reforma në drejtësi duhet të jetë për të gjetur më të mirët për të bërë drejtësi. Kjo realizohet duke dëgjuar, seleksionuar dhe vlerësuar, por ne këtu as kemi dëgjuar, as kemi seleksionuar dhe as kemi vlerësuar. Shtrembërimi i konkurseve, i proceseve konkurruese, është i dëmshëm për vendin tonë. Ne nuk kemi luksin të paracaktojmë fitues në shtet vetëm se janë simpatizantë partie apo konjukturash. Probleme të ngjashme, por edhe më të rënda, solli implementimi i reformës territoriale administrative. Shqipëria e ka të nevojshme një reformë të thellë dhe kuptimplotë në lidhje me administrimin e territorit dhe pushtetit vendor.

Reforma e ndërmarrë nga qeveria në vitin 2015 ishte e cunguar dhe nuk përmbushi synimet për të ofruar decentralizim më të madh, autonomi vendore, unifikim territorial dhe subsidiaritet. Premtuan eficiencë financiare, madje kishte edhe shifra. Deklaruan se vetëm në vitin e parë të implementimit të kësaj reforme do të kishim 80 milionë euro përfitim nga strukturimi i burimeve njerëzore. Tashmë e ka të qartë çdo qytetar, nga 19 mijë punonjës në vitin 2015, sot llogariten rreth 34 mijë punonjës vendorë, pa përfshirë punonjësit me kontratë. Ky është rezultati i reformës territoriale: dështimi i radhës. Nga një reformë, e cila supozohej të rriste performancën e bashkive të vendit, t'i sillte ato më afër qytetarëve, duke ulur taksat dhe rritur llogaridhënien, qytetarët morën më shumë individë që kishin lidhje me krimin dhe ligjin për dekriminalizimin në krye të bashkive të vendit, rritje të taksave, më pak demokraci dhe instalimin si askund në botë të një totalitarizmi vendor. Kryetarët e njësive vendore u distancuan gjithnjë e më shumë nga nevoja dhe domosdoshmëritë e qytetarëve, ndërkohë që centralizimi fiskal u thellua gjithnjë e më shumë. Qytetari u vendos në periferi të bashkisë dhe nevojat e tij në periferi të programeve të qeverisë qendrore. Shqiptarët duhet të rifitojnë demokracinë e humbur, e cila u sakrifikua, ndërkohë që pushteti vendor u centralizua gjithnjë e më shumë. Qytetarët u distancuan nga vendimmarrja dhe referendumet u kthyen gjithnjë e më të pamundura. Duhet të rikthejmë edhe një herë bashkinë në një institucion që ka në themel nevojat e qytetarit, duke mundësuar rritjen dhe fuqizimin e rolit të qytetarit në kërkesë llogarie, duke fuqizuar edhe më tej të drejtën e votës për banuesit. Për shembull, në një bashki si Dibra, me 14 njësi vendore, që i bashkohen bashkisë qendër, qytetarit nga Lura i duhet të udhëtojë për 4 orë që të marrë një shërbim në bashkinë qendër. Pa llogaritur stërmundimin për të marrë shërbim në një bashki të korruptuar, si ajo e Dibres, me një administratë të mbushur me socialistë të paaftë, të korruptuar dhe injorantë në të shumtën e rasteve. Ish - komunat u sakrifikuan pa shërbime bazë ndaj tyre, pasi tendenca është që shërbimet t'i kryhen vetëm qytetit.

Sot kemi fshatra që, edhe për shkak të peshës elektorale, nuk marrin shërbime pastrimi, ndriçimi, për rrugë nuk bëhet fjalë, apo shërbime transporti. Dështimin e reformës territoriale e justifikojnë të dhëna e statistika pa fund. Uroj që për sa citova të bëjmë çmos që me reformën e re të kemi mundësi t'u përgjigjemi kërkesave të qytetarëve dhe t'ua kthejmë bashkitë qytetarëve. Faleminderit!